



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë 19.05.2025

Numër Protokolli: 3643/2025

A.nr.673/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën A.nr.673/2025, të datës 17.04.2025, të parashtruar nga ankuesi F.M,kundër Njoftimit të datës 26.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.05.2025 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.673/2025, e datës 17.04.2025 e parashtruar nga ankuesi F.M.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, F.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 16.04.2025 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është regjistruar me datë 17.04.2025 dhe numër protokolli 2527/2025 nën shenjën A.nr.673/2025, kundër Njoftimit të datës 26.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, me datën 25.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e

Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datë 06.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me procedurën në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën të datës 17.04.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Njoftimin e datës 26.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Çertifikatë e datës 23.08.1999 lëshuar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës; E-mailin e datës 16.04.2025 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.04.2025; Përgjigje në ankesë e datës 06.05.2025; Konkursin e datës 14.02.2025; Listën e aplikantëve; vendimin e datës 01.04.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPB-së; Njoftimin e datës 11.04.2025; Aplikacionin e ankuesit të datës 17.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur të aplikimit;

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit në këtë fazë **është e palejuar**, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.02.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00016740, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës “Zyrtar për Regjistrim Civil”, në Shtërpecë/Agjencia e Regjistrimit Civil, ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.02.2025 deri më 16.03.2025, ndërsa nga shkresat e kësaj arrihet në konstatimin se edhe ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi, nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, pasi që Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Brendshme, përmes Njoftimit të datës 26.03.2025 i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk plotëson kriteret e përgjithshme të konkursit, respektivisht ndërlidhur me kualifikimin e kërkuar arsimor nuk ka bashkangjitur Diplomën sikurse është përcaktuar në konkurs por vetëm Çertifikatë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se i është refuzuar aplikacioni në mënyrë të kundërligjshme për procedurën e rekrutimit sipas konkursit RN00016740 të datës 14.02.2025, pasi që i kam plotësuar kriteret e nevojshme, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e tij pasi që ka të mbaruara Fakultetin Ekonomik dhe se asaj kohe nuk i kanë lëshuar menjëherë Diplomë, ndërsa aplikacionin e tij ta vlerësoj të vlefshëm.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridike administrative, sa i përket procedurave të pranimit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit mori për bazë dispozitat e nenit 27 Paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik , i cili përcakton se: “4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo candidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil”, si rrjedhojë meqenëse ankuesi konteston procedurën e rekrutimit që ndërlidhet me fazën e verifikimit paraprak, atëherë Kolegji i Këshillit konstaton se mënyra e parashtrimit të ankesës lidhur me procedurat e pranimit në

:

Shërbimin Civil është rregulluar me nenin 44 paragrafi 10 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik i cili përcakton se: “10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, ***pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative***”, dhe me nenin 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku është përcaktuar se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, ***pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve***”.

Kolegji i Këshillit duke marrë parasysh provat e lëndës si dhe duke ju referuar dispozitave të cekura si me lartë konstaton se ankuesi ankesën e datës 17.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil e ka parashtruar para shpalljes së rezultateve përfundimtare, gjegjësisht Kolegji i Këshillit konstaton se meqë procedura e ankimit ndaj procedurës së pranimi është parashikuar sipas dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, atëherë ankesa e parashtruar para shpalljes së rezultateve përfundimtare është në kundërshtim me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk nënkupton shpalljen e rezultateve përfundimtare në kuptim të nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, pasi që procedura e rekrutimit në rastin e konkursit ndaj të cilit ankuesi ka parashtruar ankesë ende nuk kishte përfunduar në kuptim të nenit 44 paragrafi 10 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht të paktën deri me datë 06.05.2025 sipas përgjigjes së dhënë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPB-së, si dhe konstatimit edhe në sistemin online të rekrutimit [ëëë.konkursi.org-gov.net](http://eëë.konkursi.org-gov.net).

Bazuar si me sipër si dhe duke ju referuar provave të lëndës Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e datës 17.04.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil, është e pa lejueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse e njëjta është parashtruar në fazat fillestare të procedurës së rekrutimit gjatë të cilave ligji material nuk e ka përcaktuar të drejtën e ankesës në KPMSHCK.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

:

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.673/2025, datë 28/05/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.M;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe; Arkivit të KPMSHCK-së.